



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Tiranë 24/12/2007

Njoftim për shtyp

Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë për ndërmarrjet prodhuese të betonit në qarkun e Tiranës

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2007, shqyrtoi rastin e marrëveshjes mes ndërmarrjeve të prodhimit të betonit në Qarkun e Tiranës. Me vendimin nr 56, datë 24 shtator 2007 “Për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit të betonit në qarkun e Tiranës”, Komisioni i Konkurrencës kishte vendosur ndalimin e menjëhershëm të marrëveshjes.

Në zbatim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e ndërmarrjeve prodhuese të betonit në qarkun e Tiranës. Pasi shqyrtoi raportin e Sekretariatit dhe pretendimet e palëve, Komisioni i Konkurrencës arriti në konkluzionin se marrëveshja nuk është zbatuar praktikisht nga ana e ndërmarrjeve antare të Unionit të Prodhuesve të Betonit.

Nga ana tjetër, Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobitjen e 9 kompanive prodhuese të betonit për shkak se nuk kanë dhënë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës. Në bazë të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 73, pika 1, një veprim i tillë konsiderohet si shkelje e lehtë.

Për sa më lart, Komisioni i Konkurrencës vendosi të gjobisë ndërmarrjet në shumat si vijon:

Ndërmarrja	Gjopa e llogaritur(lekë)
"ALBAN - TIRANA CO"	447915
BEST CONSTRUCTION ALB	235367
BETON EKSPRES	178534
FERRO BETON & CONST.	436959
HALILI	172519
ITAL-BETON CONST.	201086
KIRCHBERGER - ALBANIA	508279
QARRI - 02	169652
SHKODRA BETON	396974